



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

INFORMACION

**MBI DETYRIMET E TRASHËGUARA TË KËSHILLIT TË QARKUT DHE
AMORTIZIMIN E TYRE PËR 8/MUJORIN E PARË TË VITIT 2023**

Në zbatim të Ligjit “Për Buxhetin e vitit 2023”, Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 2 datë 19.01.2023 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2023”, Udhëzimit nr. 26 datë 27.09.2019 “Procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për njesitë e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimin nr. 37 datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, Vendimit të Këshillit të Qarkut nr. 18 datë 21.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2023”, gjatë vitit 2020 dhe 2021 është punuar fort për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe uljen e stokut të borxhit, pa krijuar vështirësi financiare në financimin e shpenzimeve të periudhës aktuale. Gjatë vitit 2022 është bërë vetëm një sistemim i detyrimeve të trashëguara me vendimin e Këshillit të Qarkut nr.13 dt.26.09.2022. Gjendja aktuale e stokut të borxhit është 280 mijë leke të ndara si më poshtë:

- Mallra dhe shërbime 160 mijë leke
- Te tjera 120 mijë leke

Të gjitha detyrimet i takojnë periudhës para vitit 2015 në një kohë kur Institucioni ka kaluar vështirësi financiare, të trajtuara shumë herë në Këshillin e Qarkut.

Një pjesë e mirë e këtyre detyrimeve të ngelura ka mungesë dokumentacioni dhe për këtë arsye likuidimi i tyre është i vështirë.

Në bazë të analizës të bërë për periudhën 8/mujori i parë 2023, detyrimet e trashëguara gjëncje në 31.08.2023 kapin 0.19 % të totalit të shpenzimeve të planifikuara dhe Këshilli i Qarkut është në një situatë financiare normale. Institucioni ka planifikuar amortizimin e borxhit brenda Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026. Këshilli i Qarkut ka marrë të gjitha masat për zbatimin e këtij programi dhe mos lejimin e borxheve të krijuara rishtas.

Bashkangjitur do të gjeni të gjitha tabelat që pasqyrojnë këtë situatë.

Korçë, më 20.09.2023

Oljona Beqiraj
Pergjegjëse e Financës